

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6992
E shtunë, 9 shtator 2023
Çmimi 0.40

Kurti: Greqia është më afër njohjes së Kosovës FAQE 2



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MË 14 SHTATOR ËSHTË PARALAJMËRUAR TAKIMI I RADHËS NË MES TË KURTIT DHE VUÇIQIT FAQE 4-5

TAHIRI: OPOZITA DUHET T'I SHPALLË 'VIJAT E KUQE' PËR TAKIMIN E RADHËS SË DIALOGUT



Ish-kryenegociatorja e Kosovës në bisedimet me Serbinë, Edita Tahiri, ka theksuar se opozita duhet t'i shpallë 'vijat e kuqe' për takimin e radhës të dialogut të

Brukselit i cili është paralajmëruar më 14 shtator. Ajo ka theksuar se temë kryesore në këtë takim do të jetë Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe.

Ish-kryenegociatorja Tahiri ka theksuar nuk duhet të befasonemi nëse Kurti në këtë takim do të dalë me statut për Asociacionin

INTERVISTA E NJË BURRËSHTETASI NGA KAFAZI I GJYKATËS SPECIALE RACISTE!

Hashim Thaçi, bashkë me të tjerët që po mbahen pengje, nuk e ka shkruar historinë. E ka bërë dhe e kanë bërë historinë



Shkruan:
Behxhet
Sh. SHALA –
BAJGORA



VOTIMI PËR LARGIMIN E KRYETARËVE, ZGJEDHJE APO REFERENDUM? FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbl: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



DEPUTETJA DELIU PADITË PËR SHPIFJE MINISTREN ALBULENA HAXHIU F. 7

JASHARAJ: MËSIMDHËNËSIT TË MOS I LARGOJNË NGA KLASA NXËNËSIT QË NUK KANË TEKSTE SHKOLLORE F. 7

VITIA, AMBASADORIT TË TURQISË: KEMI NISUR VEPRIME KONKRETE PËR SIGURIMET SHËNDËTËSORE F. 7

EKONOMI



KAZINOTË E KARAÇEVËS BARTEN NË BREZNICË TË SERBISË F. 8

ALARMON AKB-ja: MBI 500 PUNËTORË VIJNË NGA BANGLADESHI, TURQIA DHE INDIA NË KOSOVË F. 8

SPORT



KOSOVA SONTE PËRBALLET ME ZVICRËN E SHOIPTARËVE F. 10

Hong Kongu goditet nga reshjet më të mëdha në 140 vjet

HONG KONG, 8 SHTATOR - Hong Kongu është vërsuar pas reshjeve më të mëdha të shiut për pothuajse 140 vjet, duke përmbytur rrugët e qytetit e disa stacione të metrove dhe duke detyruar mbylljen e disa shkollave.

Autoritetet në qendrën e teknologjisë kineze në Shenzhen regjistruan reshjet më të mëdha të shiut që kur nisi regjistrimi i tyre më 1952.

Ndryshimet klimatike kanë shtuar dhe forcuar stuhi të tropikale, kanë thënë ekspertët, duke shkaktuar shira dhe erëra më të fuqishme që po

shkaktojnë dëme të mëdha.

Reshjet e shiut në Hong Kong nisën të enjten dhe autoritetet thanë se regjistruan 158.1 milimetra reshje në orë, që është vlera më e lartë që kur nisën regjistrimet më 1884.

Autoritetet lëshuan paralajmërimin për vështrime, ndërkaq ekipet e shpëtimit u përfshin në operacione të shpëtimit në disa zona.

“Banorët që jetojnë afër lumenjve duhet të jenë të vetëdijshëm për kushtet e motit dhe duhet ta shqyrtojnë mundësinë e evakuimit të tyre”, tha vëzhguesi për motin në

Hong Kong.

Autoritetet kanë paralajmëruar edhe për mundësi të rrëshqitjeve të dheut.

Sekretari i Hong Kongut, Eric Chan, gjatë një konference për media tha se reshje si këto “ndodhin një herë në një shekull” duke shtuar se kushtet ekstreme të motit do të vazhdojnë deri në mesnatë, sipas kohës lokale.

Autoritetet spitalore thanë të premtën se të paktën 110 persona kanë kërkuar ndihmë, ndërkaq katër janë në gjendje serioze për shkak të lëndimeve të pësuar si pasojë e motit të



ligë.

Hong Kongu ishte goditur nga një tajfun i fuqishëm më 2018

dhe sipas autoriteteve vlera e dëmeve ishte të paktën 470 milionë dollarë.

Borrelli: Mosanëtarësimi i Gjeorgjisë në BE i shkon për shtati Rusisë

TBILISI, 8 SHTATOR - Dështimi i Gjeorgjisë për t'u integruar në Bashkimin Evropian do t'i shkonte për shtati Rusisë, ka thënë kryediplomati i Bashkimit Evropian, Josep Borell, teksa i ka bërë thirrje Tbilisit t'i zbatojë reformat demokratike.

Bashkimi Evropian e ka njohur “perspektivën evropiane” të Gjeorgjisë vitin e kaluar, mirëpo nuk e ka çuar përpara aplikacionin e anëtarësimit – ndonëse Ukrainën dhe Moldavinë i ka bërë vende kandidatë – duke thënë se Tbilisi duhet t'i bëjë fillimisht disa ndryshime.

Në një vizitë në Gjeorgji, Borelli ka thënë se “pa asnjë dyshim, Gjeorgjia i takon familjes evropiane”.

Mirëpo ai ka përmendur se Tbilisi deri më tani i ka zbatuar vetëm tri prej 12 kërkesave të BE-së, të cilat shërbejnë si parakusht që Gjeorgjia ta fitojë statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE. “Rusia do të



jetë shumë e lumtur nëse ne nuk ia dalim” për ta integruar Gjeorgjinë në BE, ka thënë Borelli në një konferencë për medie, bashkë me kryeministrin

e Gjeorgjisë, Irakli Garibashvili, duke shtuar se “Bashkimi Evropian nuk do ta braktisë Gjeorgjinë”.

Ai e ka kritikuar vendimin e

marrë së fundi nga Gjeorgjia për t'i rikthyer fluturimet e drejtpërdrejta me Rusinë, duke i bërë thirrje Tbilisit të veprojë në përputhje me politikat e BE-së

për Rusinë.

Garibashvili ka insistuar se qeveria e tij është “plotësisht në linjë me BE-në kur është fjala për luftën e Rusisë në Ukrainë, demokracinë dhe të drejtat e njeriut”.

Ai ka thënë se “vendimi më i mirë do të ishte nëse Gjeorgjia do ta merrte statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE deri në fund të vitit”. Sipas tij, nëse BE-ja dështon në ofrimin e mbështetjes për Gjeorgjinë, “diçka e tillë do të dërgojë mesazh të keq te Rusia”.

Autoritetet e Gjeorgjisë janë përballur me kritika të ashpra për shkak të vlerësimeve për ulje të shkallës së demokracisë në këtë vend dhe bashkëpunim me Kremlinin, çka i ka dëmtuar seriozisht lidhjet e Tbilisit me Brukselin.

Anëtarësimi i Gjeorgjisë në BE është synim i përfshirë në kushtetutën e këtij shteti dhe mbështetet, sipas sondazheve, nga 80 për qind e popullsisë.

Rumania ka plan për pranimin e më shumë drithërave nga Ukraina

Bukuresht, 8 shtator - Qeveria e Rumanisë do të miratojë një plan për ta përmirësuar infrastrukturën rrugore që çon për në portin e Konstantës në Detin e Zi. Ky projekt është pjesë e një investimi më të gjerë në port që mund të ndihmojë që më shumë drithë ukrainase të kalojnë transit.

Konstanta është rruga më e madhe alternative për eksportet e Ukrainës, teksa drithërat arrijnë përmes transportit rrugor, hekurudhor apo përmes lumit Danub.

Ukraina është një prej eksportuesve më të mëdha të drithërave në botë dhe

zyrtarët e qeverisë rumune kanë deklaruar se synojnë ta dyfishojnë kapacitetin mujor të drithërave ukrainase që kalojnë transit për në postin e Konstantës. Ata synojnë që vlera të arrijë në 4 milionë tonë muajt në vijim.

Qeveria ka përmirësuar dhjetëra linja hekurudhore që e lidhin shtetin me Ukrainën dhe po punon që në Dabub të kalojnë më shumë mallra.

Në portin e Konstantës, Ministria e Transportit do t'i përdorë fondet e Bashkimit Evropian për ta riparuar dhe forcuar infrastrukturën ekzistuese, do të ndërtojë rrugë të reja, por edhe do të lëshojë në përdorim një

sistem të ri të digjitalizuar për menaxhimin e trafikut. “Kjo është dëshmi e qartë se Rumania po bën përpjekje serioze për ta mbështetur Ukrainën që të eksportojë më shumë drithëra”, tha kryeministri rumun Marcel Ciolacu.

Punimet në port do të kushtojnë 155.67 milionë dollarë dhe pritet të mbarojnë pas 36 muajsh.

Që nga korriku, kur Moska u tërhoq nga marrëveshja e drithërave që mundësonte eksportin e sigurt të drithërave ukrainase nga Deti i Zi, Rusia vazhdimisht ka sulmuar portet ukrainase në Danub.



Ukraina ka eksportuar 8.1 milionë tonë drithëra përmes portit të Konstantës në shtatë muajt e parë të këtij viti. Kur të përfundojnë punimet

infrastrukture, pritet që drithërat ukrainase që kalojnë përmes Rumanisë të arrijnë në 35 milionë tonë metrikë në sezon.

Intervista e një burrështetasi nga kafazi i Gjykatës Speciale raciste!

Hashim Thaçi, bashkë me të tjerët që po mbahen pengje, nuk e ka shkruar historinë. E ka bërë dhe e kanë bërë historinë



Shkruan: Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

A mund të ketë shpërfytyrim të të pafytyrëve: Në Qendrën e Paraburgimit të Gjykatës Speciale Raciste në Hagë po mbahen si pengje të paqes heronjtë e luftës dhe të shtetndërtimit: presidenti Hashim Thaçi, kryeparlamentarët Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli si dhe Rexhep Selimi, i cili, në kohën kur u arrestua, ishte shef i grupit parlamentar i Partisë Vetëvendosje. Që të katërt themelues të së lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës (UÇK) dhe luftëtarë të pakompromis që nga orët e para. Komandant Salih Mustafa - Cali më lehtë do të kalonte i shtrirë në shtratin e Prokrustit se nga kjo gjykatë që po deklarohet se është pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës dhe se gjykon sipas ligjeve të Kosovës. Nasim Haradinaj dhe Hysni Gucati u dënuan me dënime kapitale për një vepër për të cilën përgjegjësi materiale dhe penale kanë pikërisht hetuesit, prokurorët apo gjykatësit e kësaj gjykate sepse i lëshuan me "rënie të lirë" materialet e ndjeshme ose duke i shitur shumë shtrenjtë ose me qëllim që t'i keqpërdorin si përsheptues për arrestimin e Katërshes së Madhe të UÇK-së që tani po mbahen pengje. Kushëriri im (nga mbiemri) Pjetër Shala është duke u gjykuar dhe pa asnjë dyshim dënimin e ka të prerë.

Këta burra janë duke u mbajtur peng deri më tani, qoftë të paraburgosur apo të dënuar. Nuk duhet të jeni aspak ekspert e të nxirrni një përfundim mbi kredibilitetin e dëshmitarëve, të mbrojtur apo të pambrojtur (që kanë pranuar të dëshmojnë jashtë proceseve gjyqësore të privatizuara nga prokurorët dhe gjykatësit) për të vlerësuar mbi objektivitetin, paanshmërinë dhe pandikueshmërinë e procesit gjyqësor.

Që nga procesi i Nurembergut e deri te gjykatat ndërkombëtare, hibride dhe kombëtare ku janë gjykuar dhe dënuar të akuzuarit për krime

luftë dhe krime kundër njerëzimit, nuk ka pasur gjykim më të mbyllur, më jotrashfrendur, më të redaktuar dhe më dhunues se ky gjykim që është duke vazhduar edhe tani dhe do të vazhdojë deri në kohën kur do të ketë interes politik dhe përfitim ekonomik. Nuk ka proces gjyqësor ku është dhunuar aq shumë parimi i publicitetit, si një ndër garantuesit për një gjykim të drejtë, të paanshëm dhe të pandikuar nga politika, parapolitika apo grupet e interesit.

Edhe në kohën e inkuizicionit apo egzorcizmit, në përpjekje të nxjerrin djajtë nga të pafajshmit, nga vetë djajtë e inkuizicionit (kleri dhe ndonjë gjykatës eventual), gjykimi që në të shumtën e rasteve ka përfunduar me kalljen e viktimave të pafajshme në stivë të drunjve, ka qenë publik dhe në prani të shumë qytetarëve.

Merreni me mend distancën historike dhe kohore midis inkuizicionit dhe kësaj Gjykate Speciale Raciste në kontekstin e respektimit dhe zbatimit të parimit të publicitetit. Kryetari i trupit gjykues, Çarls Smith duhet të ndjehet i turpëruar para Kozimo Mediqit apo kardinalit Rishelje për mënyrën se si e udhëheq gjykimin, fletë për hapje të procesit, bashkë me prokurorin e mbyllë edhe më shumë, deri në premtimin e radhës.

Gjykata Speciale Raciste thuhet se është e Kosovës dhe e vetmja lidhje me Kosovën është se institucionet aktuale në Kosovë kanë të njëjtin qëndrim me Gjykatën Speciale sa i përket personave të arrestuar e që janë duke u gjykuar.

Nuk ka vend në botë ku shkelet aq rëndë dhe aq papërgjegjshëm parimi i prezumimit të pafajësisë sikur që po ndodhë me pengjet e Hagës, të gjithë shtetas të Kosovës dhe të gjithë shqiptarë. Dhe, të gjithë luftëtarë të lirisë dhe ndërtues të shtetit në një ambient aspak miqësor si nga ndërkombëtarët, Serbia e bën sipas detyrës zyrtare dhe një pjesë e pozitës në Kosovë dhe mendermethënë një pjesë e shoqërisë civile në Kosovë. Hartëzimi i akuzave ishte bërë në Beograd kurse nënshkrimi i këtyre akuzave ishte bërë nga një psikopat zviceran i veshur me pushtet dhe imunitet. Bomba që plasi cipën e pafytyrësisë e u hodh në Burrel



që siguroi shumë ngritje në karrierë për burokratët e Evropës, kriminelët e Serbisë dhe disa grabitqarë fondesh në Kosovë dhe Serbi të bashkëdyzuar rreth një boshti për kriminalizim të luftës së UÇK-së, rishkrim të historisë dhe futje të Kosovës nën Serbi. Sot, në Kosovë dhe në rajon janë dy mundësi të siguronit fonde lehtësisht dhe paturpësisht. E para, duke përkrahur grupet seksuale të marginalizuara (e bëjnë vetëm shkaku i fondeve dhe jo shkaku i bindjes) dhe e dyta duke sulmuar dhe akuzuar luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (e bëjnë për përfitime, me vullnet të plotë dhe me bindje se po e përmbushin detyrimin ndaj trashëgimisë "kombëtare", politike dhe morale, jugosllave dhe serbe, si pjesë e kodit gjenetik të paraardhësve të tyre).

Nuk duhet të kaloni shumë kohë para mediave elektronike e të kuptoni ecurinë dhe përfundim logjik të këtyre gjykimeve! Bijë dhe bija, motra dhe vëllezër të is-udbashëve jugosllavë dhe serbë, bijë të vrasësve e që kishin poste në ish-sistemin, sot përveç se deklarojnë çdo ditë për krime të UÇK-së për të cilat nuk kanë asnjë njohuri, edhe shkaku i moshës edhe shkaku i mospasjes së informatave përveç atyre serbe, për një grusht parash dhe urrejtjes ndaj atyre që e bënë luftën dhe e sollën lirinë sot janë në gjendje të dëshmojnë para kësaj gjykate, të liruar dhe të çliuar nga çdo ndjenjë dhe përgjegjësi morale dhe njerëzore. Shumicën e dëshmitarëve, të mbrojtur dhe të pambrojtur që kanë dëshmuar para kësaj gjykate i

njoh sikur që i njej edhe publiku kosovar. Me Fredin kam pasur bashkëpunim shumëvjeçar dhe pikërisht KMDLNj-ja ka qenë pikënisja e thujta të gjitha aktiviteteve që i ka bërë në Kosovë. Më njej shumë mirë dhe e njoh shumë mirë. Organizata për të cilën ka punuar nuk ka pasur kapacitet operacional në Kosovë as para, as gjatë e as pas përfundimit të luftës prandaj ka marrë informata prej burimeve të ndryshme në Kosovë e tash po del, sipas dëshmisë para gjykatës edhe më shumë në Serbi. Po del se dëshmitë nga Serbia janë shtylla kurrizore e fakteve që i prezanton para kësaj gjykate. Sikur edhe disa organizata që kokën e kanë në Beograd e trupin në Kosovë. Keq ka sharruar për Shtëpinë e Verdhë në Burrel edhe pasi nuk u sigurua asnjë provë materiale për trafikim me organe njerëzore që shërbeu si bombë shurdhuese për raportin e Dik Martit sikur që po sharrojnë do psikopatë në Kosovë të cilët të vetmen lidhje me luftën e kanë urrejtjen ndaj luftës që po e përdorin si platformë dhe mundësi për përfitim fondesh. Psikopatë të çastit, në shërbim të nostalgjisë jugosllave dhe serbe.

Burrështetasi dhe politikanët mediokër: Hashim Thaçi, president i Kosovës e dha një intervistë nga paraburgimi i Gjykatës Speciale Raciste. Një intervistë ku përfshiheshin shumë gjëra, personale, familjare, politike dhe shtetërore. Kjo pak e ngarkon intervistën mirëpo është fakt i pamohueshëm se pjesa politike është intervistë e një burrështetasi dhe jo e një

politikani mediokër. Është pjesë ku e sfidon edhe fatin e vet për çështjen e përgjithshme. Hashim Thaçi, bashkë me të tjerët që po mbahen pengje nuk e ka shkruar historinë, e ka bërë dhe e kanë bërë historinë. Politikani mediokër merr vendime të vogla sepse nuk ka kapacitet, guxim, motiv e as përkushtim për vendime të mëdha. Prandaj asnjëherë nuk del nga mediokriteti. Mediokritetin e ka diplomë, e ka shtytje, e ka arsyetim për ikje nga përgjegjësia kur përballet me vendime të mëdha. Prandaj kurrë, për dallim nga Hashim Thaçi nuk bëhet burrështetas. Burrështetasit marrin vendime të rënda, të kushtueshme dhe të dhimbshme për ata që nuk shohin më larg se hunda, ndërsa burrështetasit shohin me mend dhe jo me sy. Rezultatet shihen më vonë. Kosova sot ka nevojë për burrështetas të cilin nuk e ka. E kanë dërguar "në kafazin e Xhengis Kanit" në Hagë, bashkë me bashkëluftëtarë, deri sa të na i prejnë rrobat.

Është interesant fakti se personalitetet që krijojnë histori, që sfidojnë jetën dhe vdekjen për interes të përgjithshëm, që vetëmohimin e kanë pjesë të pandashme të karakterit, temperamentit, ndërgjegjes, vetëdijes dhe moralit, vlerësohen drejtë vetëm pasi të ketë kaluar një distancë kohore, sidomos te shqiptarët. Me Hashim Thaçin mund edhe të mos pajtoheni por një gjë asnjëherë nuk mund ta mohoni, se ishte dhe mbeti një burrështetas duke arritur majat e synimeve kombëtare, politike dhe shtetërore, në përputhje me mundësitë që i kishte.



MË 14 SHTATOR ËSHTË PARALAJMËRUAR TAKIMI I RADHËS NË MES TË KURTIT DHE VUÇIQT

Tahiri: Opozita duhet t'i shpallë 'vijat e kuqe' për takimin e radhës së dialogut

Ish-kryenegociatorja e Kosovës në bisedimet me Serbinë, Edita Tahiri, ka theksuar se opozita duhet t'i shpallë 'vijat e kuqe' për takimin e radhës të dialogut të Brukselit i cili është paralajmëruar më 14 shtator. Ajo ka theksuar se temë kryesore në këtë takim do të jetë Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe. Ish-kryenegociatorja Tahiri ka theksuar nuk duhet të befsohemi nëse Kurti në këtë takim do të dalë me statut për Asociacionin

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Përfaqësuesi i Lartë i BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell, ka njoftuar se takimi i radhës i kryeministrit të Kosovës, Albin Kurtit, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, do të zhvillohet më 14 shtator.

Kurti dhe Vuçiqi janë takuar për herë të fundit më 2 maj - nëntë ditë pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme në veri të Kosovës, të cilat janë bojkotuar nga popullata lokale serbe. Nga ajo kohë mes dy vendeve ka pasur një sërë tensionesh dhe krizash.

Ish-kryenegociatorja e Kosovës në bisedimet me Serbinë, Edita Tahiri, ka theksuar se opozita duhet t'i shpallë 'vijat e kuqe' për takimin e radhës së dialogut të Brukselit.

Tahiri ka thënë se nuk duhet të befsohemi që Kurti të dalë me statut për Asociacionin në takimin e radhës. "Opozita duhet t'i shpallë 'vijat e kuqe' për takimin e radhës së dialogut të Brukselit siç janë: Jo kompetenca ekzekutive për Asociacionin, jo nivel i tretë i qeverisjes, po zbatim të plotë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese për statutin e Asociacionit. Të mos befsohemi që Kurti të dalë me statut në atë takim, të cilën po e bën 'nën rrogëz', ka deklaruar Tahiri të premten.

Ajo ka thënë se kësaj here amerikanët nuk do të lejojnë Kurtin ta fshehtë përmbajtjen e bisedimeve. "Prej diskutit të luftës të marrëveshja pa njohje, pranimi i Asociacionit, autonomi për pakicën serbe, tensionet në veri, ndërsa tash te zbatimi i Asociacionit që do të jetë temë qendrore në dialogun e radhës - amerikanët do të na tregojnë se

çfarë u bisedua; nuk do ta lejojnë Kurtin ta fshehtë përmbajtjen e bisedimeve siç ka bërë deri më tash", ka thënë Tahiri.

Këtë të mërkurë i dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialog, Miroslav Lajçak, është takuar me zëvendëskryeministrin e Kosovës, Besnik Bislimin, për të biseduar rreth përgatitjeve për takimin e nivelit të larg të dialogut mes Prishtinës dhe Beogradit për javën e ardhshme. "Ne e patëm një diskutim të gjatë dhe përmbajtësor për t'u përgatitur për takimin e dialogut të nivelit të lartë javën e ardhshme", ka shkruar Lajçaku në rrjetin social "X".

Ai ka theksuar se përqendrimi i tyre kryesor në takimin e 6 shtatorit në Bruksel ishte "si të përparojmë në normalizimin e marrëdhënieve".

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i ka akuzuar "aleatët e

Rusisë" se përmes dezinformimit dhe sjelljeve të tjera dashakeqe në fushën kibernetike, po ndikojnë në procesin e normalizimit të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Kurti gjatë samitit "Open Government Partnership" në Talin të Estonisë ka thënë se këto veprime në Kosovë janë duke u forcuar. "Në Kosovë përpjekjet nga aleatët e Rusisë për ta shtrembëruar të vërtetën, të kaluarën dhe të tashmen janë të dukshme dhe po intensifikohen. Gjatë kohës së ndjeshme, kur shteti ynë është i përkushtuar në procesin e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara për t'i normalizuar raportet me fqinjën tonë verior, Serbinë, por edhe për përfshirjen e plotë të minoriteteve në proceset demokratike të shtetit, pa ndikim nga jashtë, këto kërcënime kibernetike, sikurse dezinformimi, bullizimi kibernetik dhe forma të tjera, janë veçmas përcaktuese", ka theksuar Kurti.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka akuzuar Serbinë se po synon të zbatojë një plan destabilizues në Ballkanin Perëndimor, të ngjashëm me

atë, siç ka thënë ajo, që e realizoi Rusia në Ukrainë më 2014.

Osmani, që qëndroi në vizitë zyrtare në Shqipëri, tha se të gjitha shtetet demokratike në rajon nuk duhet ta lejojnë zbatimin e këtij plani. "Nuk është situata në veri ajo që ka acaruar dialogun Kosovë - Serbi. Është Serbia ajo që gjithnjë acaron situatën në rajonin tonë nëpërmjet sulmeve të njëpasnjëshme ndaj Kosovës. Nuk ka javë që kalon që dikush nga Serbia nuk gjuan me armë policët e Kosovës në territorin e Kosovës. Duke zbatuar në përpikëri planin që [presidenti rus, Vladimir] Putini kishte zbatuar në vitin 2014 kundër Ukrainës, [presidenti serb, Aleksandër] Vuçiqi dhe Serbia po synojnë ta destabilizojnë të gjithë Ballkanin Perëndimor, e nëpërmjet destabilizimit të rajonit tonë t'i atakojnë vlerat dhe sistemin e vlerave mbi të cilët qëndrojnë BE-ja dhe NATO-ja", ka thënë Osmani, duke iu referuar tensioneve në veri të Kosovës.

Ish-ministri i Jashtëm i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka thënë se me dyshen Osmani - Kurti procesi i dialogut është zvogëluar rreth gabimeve strategjike të Kosovës dhe jo interesave të saj.

Votimi për largimin e kryetarëve, zgjedhje apo referendum?

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Me Udhëzimin Administrativ që ka nxjerrë Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të Kosovës për largimin e kryetarëve të komunave nga detyra, nuk do të mund të organizohen zgjedhje të reja, thonë disa njohës të çështjeve juridike-kushtetuese. Sipas tyre, votimi në bazë të këtij udhëzimi është një formë e referendumit, për të cilin Kosova nuk ka bazë ligjore.

Udhëzimi Administrativ, i cili është bërë publik këtë javë, parasheh fillimisht iniciimin e një peticioni për shkarkimin e kryetarit të komunës përkatëse dhe nënshkrimin e tij nga 20 për qind e votuesve të asaj komune. Më pas peticioni me nënshkrime do t'i dërgohej kryesuesit të kuvendit komunal dhe ai do ta dërgonte atë për verifikim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Nëse KQZ-ja vlerëson se janë ndjekur hapat e duhur, ajo organizon votimet për largimin e kryetarit nga funksioni.

Për largimin e tij do të duhen 50 për qind plus një votë e qytetarëve.

Nevoja për këtë udhëzim administrativ ka ardhur pas kërkesave të komunitetit ndërkombëtar që Kosova të organizojë zgjedhje të reja në komunat me shumicë serbe në veri me qëllim shtensionimin e situatës në atë zonë.

Iniciativë "e kotë"

Kadri Kryeziu, ish-nënkryetar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, thotë se votimi që do të mund ta pasonte peticionin për largimin e kryetarit të komunës do të ishte "njëfarë mini-



referendumi", i cili "nuk është i paraparë me ligj". "Ky veprim mua më duket se është i kotë dhe se nuk do të ketë efekte në arritjen e objektivave", thotë Kryeziu për Radion Evropa e Lirë.

Valdete Daka, ish-kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, thotë se votimi eventual, të cilin e parasheh Udhëzimi Administrativ, nuk mund të cilësohet si "proces zgjedhor". "Nuk mund t'iu referohet zgjedhjeve sepse, në këtë rast, qytetarët do të votonin për 'po' ose 'jo' - do të thotë, a dëshirojnë ta largojnë kryetarin apo jo. Kjo nuk mund të quhet zgjedhje. Ky është vetëm referendum", thotë Daka për "Radion Evropa e Lirë".

Ajo kujton se KQZ-ja e ka për obligim të organizojë zgjedhje dhe referendume porse, siç thotë, Ligji për Zgjedhje ekziston, kurse ai për

referendum jo. "Për të pasur kompetencë KQZ-ja që ta organizojë një votim të tillë duhet të ekzistojë Ligji për Referendum. Atë ligj nuk e kemi dhe këtu mbaron e gjitha, sipas meje", shprehet Daka.

"Radio Evropa e Lirë" kontaktoi përmes telefonit kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Kreshnik Radoniqi, për ta pyetur nëse KQZ-ja mund të organizojë procese eventuale të votimit për shkarkimin e kryetarëve. Por, Radoniqi tha se është "jashtë vendit" dhe se "nuk ka kohë të përgjigjet".

REL-i tentoi të bjerë në kontakt edhe me sekretariatën e KQZ-së si dhe me zëdhënësin e këtij institucioni, por ata nuk ishin të qasshëm.

Iu drejtua edhe Qeverisë së Kosovës me pyetjen nëse Ligji për Referendum është i nevojshëm për organizimin eventual të votimeve për

shkarkimin e kryetarëve, por nuk mori përgjigje.

Në këtë pyetje, REL-it nuk iu përgjigj as Departamenti Ligjor i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Në një intervistë dhënë më 6 shtator, ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Enver Hasani, tha për REL-in se Udhëzimi Administrativ për largimin e kryetarëve është kundërkushtetues dhe kundërligjor.

Si përcaktohet nëse është referendum?

Kosova nuk ka ligj për referendum. Kuvendi i Kosovës ka miratuar në parim projektligjin për këtë çështje në vitin 2018, por procedurat nuk kanë shkuar më tutje.

Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi thotë se Ligji për Referendumin ose çfarëdo baze

ligjore mbi të cilën do të mbështetej Udhëzimi Administrativ nuk mund të iniciohet te ligjvënësit. "Udhëzimi administrativ nuk mund t'i paraprijë në asnjë rrethanë ligjit, sepse udhëzimi administrativ zakonisht shërben për ta zbatuar ligjin në praktikë dhe nuk mund prodhojë pasoja që udhëzimi administrativ ta detyrojë Kuvendin të miratojë ligj të caktuar", thotë Miftaraj.

Si ka lindur nevoja për Udhëzimin Administrativ?

Në bazë të një marrëveshjeje me Bashkimin Evropian, Kosova ka treguar gatishmëri për organizimin e zgjedhjeve të reja në katër komunat me shumicë serbe në veri: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq.

Në bazë të një marrëveshjeje me Bashkimin Evropian, Kosova ka treguar gatishmëri për organizimin e zgjedhjeve të reja në katër komunat me shumicë serbe në veri: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq.

Këta kryetarë kanë dalë nga zgjedhjet e jashtëzakonshme të prillit të cilat i ka bojkotuar komuniteti serb.

Si opsion për qetësimin e situatës, BE-ja ka kërkuar zgjedhje të reja dhe Prishtina zyrtare ka thënë se është pajtuar. Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë, zgjedhjet e parakohshme për kryetarë mbahen në tri raste: nëse kryetari jep dorëheqje, nëse qytetarët e kërkojnë shkarkimin e tij përmes peticionit, nëse kryetari nuk paraqitet në vendin e punës për më shumë se një muaj pa arsye.

Kurti: Greqia është më afër njohjes së Kosovës

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Kryeministri Albin Kurti ka theksuar se Kosova po punon fort në planin diplomatik për t'i bindur pesë vendet e mbetura të BE-së që ta njohin Kosovën. Në intervistën për televizionin polak "TVP World", Kurti ka thënë se prej pesë vendeve, Greqia është afër njohjes.

Përgjatë këtyre viteve Kosova ka shënuar përparim të caktuar për sa i përket komunikimit dhe bashkëpunimit me pesë vendet e BE-së që ende nuk e kanë njohur Kosovën brenda Bashkimit Evropian prej 27 shteteve, ka theksuar fillimisht kryeministri Albin Kurti.

"Kemi punuar fort në aspektin diplomatik, që ato t'i bashkohen shumicës së

vendeve të BE-së. Greqia është në ballë të këtyre vendeve, e cila është afër njohjes së pavarësisë së Kosovës. Këtë e tregon edhe statusi i Zyrës sonë në Athinë. Me BE-në kemi të nënshkruar Marrëveshjen kontraktuale të Stabilizim Asociimit dhe që nga Samiti i Selanikut në vitin 2003, perspektiva e integritetit të Ballkanit Perëndimor në BE është kthyer në politikë të Bashkimit Evropian. Ne do të bëhemi pjesë e BE-së sa më shpejt që të jetë e mundur dhe mendojmë se procesi i integritetit në BE i shërben vendit tonë", ka thënë Kurti.

Në këtë kontekst, Kurti ka thënë se Kosova ka nevojë për ndihmën e shteteve që e kanë

njohur. "E bëjmë për vendin tonë duke plotësuar vlerat, standardet dhe parimet, në të njëjtën kohë kemi nevojë për ndihmën e Bashkimit Evropian. Gjithëpërfshirja jonë në BE nuk i shërben vetëm interesit tonë, së mirës sonë, sepse edhe ne duam të kontribuojmë. Bashkimi Evropian është projekti më i rëndësishëm historik dhe politik për paqen dhe prosperitetin që nga Lufta e Dytë Botërore. Kemi nevojë për ndihmën e shteteve që na kanë njohur, për të na njohur vendet mosnjohëse: Kemi nevojë për 22 nga 27 vendet e BE-së, për 26 nga 30 vendet e NATO-s dhe ndihmën e 34 vendeve nga 46 në Këshillin e Evropës", ka theksuar Kurti.



Nura viziton objektin e Qendrës për Punë Sociale pas renovimit

SKENDERAJ, 8 SHTATOR - Pas përfundimit të renovimit të objektit të Qendrës për Punë Sociale, i cili u realizua në bashkëpunim në mes të komunës së Skenderajt dhe Islamic Relief Kosova, kryetari i komunës, Fadil Nura dhe

drejtoresha për Shëndetësi e Mirëqenie Sociale, Rrezartë Hasani-Ibrahimi, kanë vizituar këtë institucion, për ta parë nga afër finalizimin e procesit të renovimit. Hapësira brenda Qendrës për Punë Sociale duket e rinuar

falë këtij projekti të përbashkët dhe shërbimi ndaj qytetarëve ofrohet në kushte shumë më të mira se para kohës së vërshimeve të 19 janarit, të cilat e kishin dëmtuar infrastrukturën e objektit të QPS-së.



Vonesa me pajisje të teksteve shkollore po i sfidon nxënësit dhe mësuesit në Malishevë

MALISHEVË, 8 SHTATOR - Në takimin e nëntë të rregullt të Komitetit për Komunitete në Malishevë, që drejtohej nga Amrush Helshani, i ftuar për të raportuar para anëtarëve ishte shefi i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Sabit Berisha. Ai gjatë raportimit theksoi: "Edhe pse i kishim bërë mirë përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2023/2024, vonesa me pajisje të teksteve shkollore po i sfidon prindërit, nxënësit, mësuesit dhe institucionet arsimore, për nivelin shkollor 1-5, kurse vështirësia tjetër është

shqetësuese edhe për nivelin e nxënësve VI-IX, ku këtë vit e kanë filluar me tekste të përdorura nga nxënësit e vitit shkollor paraprak. Me punën dhe aktivizimin e shumë ekipeve të angazhuara po punojmë që sa më shpejt ta tejkalojmë këtë situatë që lë shumë për të dëshiruar", ka thënë ai.

Pas mbarimit të takimit anëtarët e komitetit vizituan një familje të komunitetit pakicë që jeton në Malishevë, për ta ndihmuar dhe inkurajuar që fëmijët ta vazhdojnë shkollimin e rregullt në këtë fillimvit shkollor.



Totaj ndan mjete të punës për 275 fermerë përfitues

PRIZREN, 8 SHTATOR - Si rezultat i subvencioneve të Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në kuadër të projektit "Furnizimi me mekanizëm bujqësor - me bashkëfinancim", kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj, ka bërë ndarjen e mjeteve të punës për 275 fermerë përfitues, për modernizimin e mekanizmit bujqësor të vjetruar dhe shkaktuar, rritjen e cilësisë së shërbimeve në punimin e tokës si dhe për zvogëlimin e shpenzimeve dhe rritjen e shpejtësisë së kryerjes së punëve në ara e fusha.

Fermerët përfituan motokultivatorë me frezë, spërkatëse, motokultivatorë me frezë e kosë, roto kosë, frezë, shpërndarës plehu, mbjellëse misri pneumatik me 4 rende dhe mbjellëse gruri me 16 rende.

Totaj ka thënë se komuna e



Prizrenit do ta japë kontributin maksimal, sipas mundësive buxhetore, për përkrahjen dhe ngritjen e

kapaciteteve të bujqve. Ai ka theksuar se investimi në bujqësi është prej prioriteteve të programit të qeverisjes.

Zëvendësministri i Zhvillimit Rajonal premtan përkrahje për projekte të reja në Rahovec

RAHOVEC, 8 SHTATOR - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, me bashkëpunëtorë, ka pritur në takim zëvendësministrin e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, Ali Tafarshiku. Kryetari Latifi e ka falënderuar Tafarshikun për bashkëpunimin dhe

mbështetjen në disa projekte të rëndësishme që kjo ministri deri tash ia ka dhënë komunës së Rahovecit.

Zëvendësministri Tafarshiku u zotua se do të angazhohet për t'i dhënë përkrahje komunës së Rahovecit për realizimin e projekteve të reja.



Hyseni paralajmëron se digjitalizimi i shërbimeve në Gjilan do të bëhet së shpejti

GJILAN, 8 SHTATOR - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka paralajmëruar se digjitalizimi i shërbimeve do të bëhet së shpejti. Ai ka thënë

se ky projekt do të bëhet në bashkëpunim me studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe rektorin e Universitetit "Kadri Zeka",

Artan Dërmaku. "Bashkëpunimi i ndërsjellë me Universitetin e Gjilanit po sjell realizimin e projekteve tona, duke fuqizuar e

njëkohësisht përkrahur financiarisht studentët elitë të këtij fakulteti. Zotimet tona po përmbushen", ka thënë kryetari i Gjilanit.



Aksion simbolik para Stacionit të Policisë në Bujanoc: Numri i policëve shqiptarë është tejet i vogël

BUJANOC, 8 SHTATOR - Kryetari i Këshillit Kombëtar Shqiptar në Luginën e Preshevës, Nevzad Lutfiu, ka njoftuar për mbajtjen e një aksioni simbolik të premtën para Stacionit të Policisë në Bujanoc. “Respektojeni Kushtetutën!” ishte thirrja e këtij aksioni që i

bënë Ministrisë së Brendshme të Serbisë. “Neni 77 i Kushtetutës së Republikës së Serbisë thotë: ‘Lidhur me punësimin në organet shtetërore, në ndërmarrjet publike, organet e krahinës, vetëqeverisjes lokale duhet të kihet parasysh përbërja

nacionale dhe përfaqësimi proporcional i pakicave nacionale’. Numri i policëve shqiptarë është tejet i vogël, madje shumë prej tyre janë afër pensionit. As edhe një polic i pranuar në vitet e fundit nga komuniteti shqiptar”, ka shkruar ai në “Facebook”.



Deputetja Deliu paditë për shpifje ministren Albulena Haxhiu

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Blerta Deliu, ka njoftuar se ka dorëzuar në gjykatë padinë për shpifje ndaj ministres së Drejtësisë, Albulena Haxhiu, që, sipas Deliu, ka thënë të pavërteta në studio televizive dhe pret të marrë përgjigjen e merituar.

Ministrja Haxhiu e ka akuzuar Deliu se ka marrë më shumë se 2 000 euro pa shkuar fare në mbledhjen e Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit. “Shpifjeve të pushtetit i përgjigjemi me padi. Tendencë që me shpifje dhe fyerje ndaj opozitës me e zhvendos vëmendjen nga skandalet korruptive të kësaj qeverie nuk



kalon. As nuk frikësohemi e as nuk zbrapsem nga angazhimi

ynë për ta denoncuar krimin dhe korrupsionin e këtij pushteti.

Shihemi në gjykatë, ministre!”, ka shkruar Deliu në “Facebook”.

Ndaj lajmit për padi ka reaguuar ministrja Haxhiu. “Për çfarë më paska paditur deputetja Blerta Deliu Kodra? Për të vërtetën? Shumë mirë. Ne do ta bëjmë publik raportin financiar i cili dëshmon që e njëjta, ndonëse nuk kishte qenë pjesëmarrëse në shumicën e mbledhjeve të Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, ishte paguar për këtë në mënyrë të paligjshme. Para disa javëve për këtë e kam njoftuar me shkrim kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe, po ashtu, kam folur publikisht. Në fakt, veprimi i duhur do të ishte kthimi i mjeteve që i ka përfutur paligjshëm”, ka shkruar Haxhiu në “Facebook”.

Vitia, ambasadorit të Turqisë: Kemi nisur veprime konkrete për sigurimet shëndetësore

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka pritur në takim ambasadorin e Republikës së Turqisë në Kosovë, Tunç Angili, me të cilin ka biseduar lidhur me gjendjen e sistemit shëndetësor publik në vendin tonë. Ministri Vitia e ka njoftuar ambasadorin për angazhimin institucional për ngritjen e cilësisë së shërbimeve dhe investimet infrastrukturale të cilat do të ndikojnë në lehtësimin e marrjes së shërbimeve nga qytetarët.

Gjatë takimit është diskutuar edhe për shfrytëzimin racional



të kapaciteteve spitalore me qëllim të përmbushjes së nevojave për qytetarët. “Në kuadër të reformimit të sistemit shëndetësor jemi duke vënë në binarët e duhur aspektin legjislativ i cili është bazë për një shëndetësi moderne për brezat e ardhshëm. Gjithashtu, paralelisht jemi duke investuar në infrastrukturë si dhe duke bërë harmonizimin dhe strukturimin e kapaciteteve ekzistuese”, ka thënë ministri Vitia.

Temë diskutimi ishte edhe çështja e sigurimeve shëndetësore, ndërsa ministri Vitia tha se qeveria është e përkushtuar për përmbushjen e

kësaj objektive dhe se ka ndërmarrë veprime konkrete. Në funksion të këtij qëllimi, ai e njoftoi ambasadorin turk për fazën finale të studimit të fizibilitetit të Sistemit Informativ Shëndetësor (SISh) i cili do ta mundësojë orientimin strategjik dhe do të jetë përcaktues për zhvillimin e sistemit shëndetësor në të ardhmen. Ambasadori i Republikës së Turqisë, Tunç Angili, e falënderoi ministrin Vitia për takimin dhe ripërsëriti gatishmërinë e shtetit turk që me përvojën e tyre të kontribuojnë për realizimin e reformave në shëndetësi të cilat janë në interes të qytetarëve.

Jasharaj: Mësimdhënësit të mos i largojnë nga klasa nxënësit që nuk kanë tekste shkollore

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rahman Jasharaj, ka kërkuar të premtën nga të gjithë mësimdhënësit të mos i largojnë nga klasa nxënësit që nuk kanë tekste shkollore. Jasharaj në tryezën e organizuar nga AAK-ja, në të cilën është diskutuar për tekstet shkollore, ka thënë se ka disa zëra që disa mësimdhënës po u bëjnë

presion nxënësve lidhur me tekstet shkollore. “Paska ndonjë mësimdhënës që po u bënë presion nxënësve, që nëse nuk kanë tekste shkollore, do t’i largojnë nga ora. Të bëjmë apel, që mësimdhënësit e Kosovës të mos i largojnë nga klasa nxënësit që nuk kanë mjete shkollore. Uroj të mos kemi situata të tilla më”, u shpreh ai.

Gjatë diskutimit, Jasharaj ka treguar se ministrja e

MASHTI-t, Arbërie Nagavci, po vazhdon të mbajë inat ndaj SBASHK-ut. “Ta ngrehni zërin jo për tekstet, por për arsimin. Të gjithë këto të meta po ndodhin pasi që Nagavci është duke mësuar qasjen e gabuar të kryeministrit Kurti, që t’i nënçmojë sindikatat dhe të mos flasë me to. MASHTI nuk po na pyet asgjë. Ka shtatë muaj që Nagavci nuk na takon dhe gjuan fjalë anash”, ka thënë ai.



Kazinotë e Karaçevës barten në Breznicë të Serbisë

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Ka muajt prej se Policia e Kosovës dhe ajo e Serbisë shikojnë nga largësia një aktivitet që zhvillohet në zonën neutrale në vijën kufitare Kamenicë - Bujanoc. Së paku shtatë biznese që organizojnë lojëra të fatit janë ndërtuar në 12 muajt e fundit në atë që njihet si territor neutral në mes të dy fshatrave - Karaçevës në anën e Kosovës dhe Breznicës në anën e Serbisë.

Sipas banorëve të zonës dhe zyrtarëve të komunës së Kamenicës dhe asaj të Bujanocit, këto objekte të lojërave të fatit janë ndërtuar në zonë neutrale, pasi qytetarët e Kosovës mund t'i frekuentojnë ato pa pasur nevojë të kalojnë nëpër procedura kufitare.

“Crystal”, “Kometa”, “Flamingo”, “LasVegasCasino”, “StarClub”, “WildCasino”, “Casino-Colosseum” janë vetëm disa nga emrat e këtyre bizneseve. Në to mund të luhet bixhoz, rulet, poker dhe mund të hidhen baste sportive.

Më 4 shtator, derisa “Radio Evropa e Lirë” ishte e pranishme në zonë, u panë vetura të ndryshme para këtyre objekteve, ani pse Policia e Kosovës ishte e vendosur rreth 1.5 kilometra larg, në kodrën mbi fshatin Novoselë, ndërsa Policia e Serbisë qëndronte rreth 350 metra distancë ajrore në pikën statike në hyrje të fshatit Breznicë, në anën e Serbisë.

Veturat që shiheshin derisa hynin e largoheshin pa u penguar nga këto objekte, ishin kryesisht me targa “RKS” - Republika e Kosovës.

Prania, siç thuhet, e madhe e njerëzve që frekuentojnë këto lojëra të fatit, paraqet shqetësim për banorët si në anën e Kosovës, po ashtu edhe në atë të Serbisë.

Një banor i zonës kufitare që jeton në anën e Kosovës tha për “Radio Evropa e Lirë” se pjesa ku janë ndërtuar objektet e këtyre lojërave është bërë e rrezikshme për t'u kaluar. Ai kërkoi t'i fshihet identiteti pasi, siç u shpreh, ka shumë familjarë në fshatrat e Bujanocit dhe ka frikë se mund të përballen me probleme nga



pronarët e lojërave të fatit. “Është shumë rrezik. Ka njerëz të rrezikshëm aty. Të gjithë [pronarët] janë nga Kosova, përveç njërit që është serb, që ka lidhje me shtetin [e Serbisë]”, thotë ky banor, por pa dhënë detaje se ku i bazon këto informacione.

Në komunën e Kamenicës thonë se kanë kërkuar nga Qeveria e Kosovës të ndërmarrë masa për ndalimin e punës së këtyre kazinove. “Është shqetësim për komunën e Kamenicës për shkak se ato veprojnë në afërsi të komunës sonë, sepse janë në zonën neutrale. Kjo është një veprimtari që është e ndaluar me ligj te ne dhe kemi ankesa të vazhdueshme të qytetarëve të kësaj ane”, thotë Lidiona Marovca, zëdhënëse e komunës së Kamenicës, për “Radio Evropa e Lirë”.

Organizimi i lojërave të fatit në territorin e Kosovës është ndaluar me ligj që nga marsi i vitit 2019. Në Serbi organizimi i lojërave të fatit lejohet dhe bizneset që e ushtrojnë këtë aktivitet licencohen në Ministrinë e Financave, pranë Autoritetit të Lojërave.

“Radio Evropa e Lirë” dërgoi pyetje në këtë institucion, për të konfirmuar nëse ndonjëri nga bizneset që funksionojnë në vijën kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë ka licencë për operim, por deri në publikimin e këtij artikulli nuk mori

përgjigje. Pyetjes së njëjtë nuk iu përgjigj as Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë.

Arifi: Kazinotë operojnë jashtëligjshëm

Por, kryetari i komunës së Bujanocit në Serbi, Nagip Arifi, thotë për “Radio Evropa e Lirë” se këto kazino veprojnë ilegalisht. Sipas tij, këto biznese nuk i kanë lejet e nevojshme për të operuar, përfshirë lejet e ndërtimit. “Është e vërtetë se janë ndërtuar disa kazino, por asnjëra prej tyre nuk ka leje. Lejet për kazino jepen në Republikën e Serbisë, i jep Ministria e Financave, kurse lejet e ndërtimit i jep pushteti lokal. Por, asnjë kazino nuk ka leje të ndërtimit, kështu që ne i kemi alarmuar organet republikane”, thotë Arifi.

Për ekzistencën e tyre ai thotë se e ka njoftuar Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë dhe atë të Financave, në kuadër të së cilës funksionon Autoriteti i Lojërave.

“Organet shtetërore të [Republikës së Serbisë] nuk marrin masa. Ato, sigurisht, e dinë interesin e vet. Sigurisht, e kanë llogaritur lejin e kazinove si interes shtetëror, sepse aty nuk ka vetëm kazino, por bëhen edhe punë të tjera, të cilat ndoshta e rrezikojnë Republikën e Kosovës”, thotë Arifi, pa dhënë detaje se për

cilat punë e ka fjalën.

Vetëm para pak ditësh, thotë ai, këto objekte janë lejuar të kycen në rrjetin energjetik në Bujanoc. Deri në fillim të shtatorit këto biznese, për shkak të afërsisë me Kosovën, kanë qenë të kyçura ilegalisht në rrjetin energjetik të Kosovës, derisa Kompania Kosovare për Distributim të Energjisë Elektrike - KEDS ka bërë shkyçjen.

Ani pse funksionojnë në pjesën e Serbisë, kabllot i kanë pasur të lidhura në disa shtëpi që gjenden rreth 50 metra larg në territorin e Kosovës.

Nga fundi i vitit 2018 deri në shtator të vitit 2020, së paku 12 lokale që organizonin lojëra të fatit funksionuan në këtë zonë, në pjesën e Kosovës. Dhjetë deri në 100 metra ishte largësia e tyre nga vija që ndan Kosovën me Serbinë në anën e Kosovës. Për shkak të disa incidenteve dhe shqetësimeve të ngritura nga banorët e fshatit Karaçevë, institucionet e Kosovës morën vendim për rriminim e tyre në shtator të vitit 2020.

Në këtë operacion u arrestuan 33 persona - në mesin e tyre edhe dhjetë zyrtarë policorë të Kosovës. Të arrestuarit u akuzuan për “veprimtari të paligjshëm, përfshirë bixhoz të paligjshëm, trafikim të njerëzve, të armëve, të narkotikëve, të mallrave dhe aktivitete të tjera kriminale”. Ministria e Punëve të

Brendshme dhe Policia e Kosovës thonë për “Radio Evropa e Lirë” se nga të dhënat që kanë, “në territorin e Republikës së Kosovës nuk ka ndonjë objekt që shfrytëzohet për qëllime të kazinove” në zonën kufitare në Karaçevë.

Banorët e Breznicës të shqetësuar

Prania e këtyre objekteve të kazinove për disa banorë të fshatit Breznicë të komunës së Bujanocit në Serbi paraqet shqetësim serioz.

Nazim Hajdini thotë se ka kërkuar vazhdimisht nga pushteti lokal në Bujanoc, por edhe nga ai qendror në Beograd, që të ndërmarrin hapa për pengimin e këtij aktiviteti, për të cilin shprehet i bindur se është ilegal. “Ne, fshati ynë, udhëtojmë pranë atyre kazinove çdo ditë. Aty ka pasur shumë incidente. Ne kalojmë me familje aty dhe mund të pësojmë. Aty ka rrezikshmëri të lartë”, thotë Hajdini.

Ai tregon se, në të kaluarën, ka qenë administrator i fshatit dhe se kërkesë për t'i mbyllur këto kazino ka bërë edhe zyrtarisht. “Zyrtarisht u kam kërkuar [nivelit lokal dhe qendror]. Të gjitha [kazinotë] punojnë në të zezën, të gjitha”, thotë Hajdini.

“Radio Evropa e Lirë” pyeti misionin paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, nëse ka ndonjë përgjegjësi sa i takon vijës kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë, sidomos zonës neutrale mes dy shteteve, por nuk mori përgjigje.

Në këtë vijë kufitare ka pasur disa incidente dhe aksione të policisë kundër kontrabandës së mallrave, kafshëve dhe trafikimit të njerëzve. Që nga aksionet e para për mbylljen e lojërave të fatit në vijën kufitare në mes Kosovës dhe të Serbisë, në Karaçevë, penalisht janë proceduar më shumë se 90 persona të arrestuar në aksione të ndryshme.

Alarmon AKB-ja: Mbi 500 punëtorë vijnë nga Bangladeshi, Turqia dhe India në Kosovë

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Aleanca Kosovare e Biznesit (AKB), e udhëhequr nga Agim Shahini, ka shprehur shqetësim për ikjen e të rinjve për në shtetet e BE-së, pasi për çdo vit me viza pune po ikin mbi 50 mijë qytetarë të Kosovës.

Shqetësimi edhe më i madh i këtij institucioni është edhe ardhja e shumë të rinjve nga Bangladeshi, Turqia dhe India, nga të cilët rrezikohemi të ndryshohet edhe struktura

demografike në një të ardhme të afërt në Kosovë. “Aleanca Kosovare e Biznesit është shprehur e shqetësuar pse të rinjtë e Kosovës ikin në BE për çdo vit me viza pune rreth 50 mijë veta dhe në vend të tyre vijnë punëtorë nga Bangladeshi, Turqia e India. Sipas një studimit të AKB-së tregu i punës po varfërohet nga kosovarët çdo vit e po plotësohet nga të huajt për të cilët as ndërmarrësit kosovarë nuk i punësojnë me dëshirë, por kanë

nevojë për t'i mbajtur aktiv punën e vet dhe aktivitetet ekonomike dhe biznesore në Kosovë, kurse të rinjtë tonë i lënë vendet bosh, familjen, prindërit dhe kanë qëllim migrimin jashtë, ku pas liberalizimi të vizave nga 1 janari 2024, viti i parë do t'i merr me veti rreth 150 mijë veta, me këtë trend vendi ynë rrezikon të ndryshojë edhe strukturën demografike në një të ardhme nga migrimi i kosovarëve”, ka njoftuar AKB-ja.



Elon Musk, një njeri i vetëm nuk duhet të ketë kurrë kaq shumë pushtet



Harrojeni pasurinë e tij, shkruan Ronan Farrow në The New Yorker. Është pushteti i pakufi që Elon Musk ka sot, që duhet të na trondisë. Kompania e raketave në pronësi të miliarderit, SpaceX është aktualisht i vetmi mjet me të cilin NASA mund të çojë astronautë në hapësirë, nga SHBA. Një tjetër sipërmarrje e tij, Tesla, kontrollon rrjetin më të madh kombëtar të stacioneve të karikimit të makinave elektrike. Ndërkohë, shërbimi i tij i internetit satelitor, Starlink, është mjete kryesor i komunikimit në fushëbetëjen e Ukrainës. Zyrtarëve të Pentagonit iu desh t'i


luten Elon Musk-ut vjeshtën e kaluar, pasi disa njësi ukrainase humbën aksesin në atë sistem. Musk kishte kërkuar më herët që SHBA të paguante për shërbimin me ulje çmimi që ai po i jepte Ukrainës, dhe kishte filluar të shtynte për një plan paqeje prorus, me sa duket i ëndërruar pas bisedimeve kokë më kokë me Vladimir Putinin. Tashmë SHBA ka firmosur një marrëveshje për Starlink, por zyrtarët e Pentagonit mbeten të sikletosur dhe të shqetësuar nga varësia e krijuar prej Elon Musk. “Jemi në dorë të humorit të tij, dhe kjo ta shpif”, tha një prej tyre.

Sjellja me ulje-ngritje e Musk e bën pushtetin e tij edhe më alarmues, shkruante Peter Csathy në The Wrap. Shikoni përpjekjet e tij dështake për të ribërë X, që më parë njihet si Twitter. Që kur e bleu platformën vitin e kaluar, ai është armiqësuar me kompanitë e reklamave dhe përdoruesit, duke lejuar lulëzimin e gjuhës së urrejtjes si dhe duke dëbuar pjesëtarë të stafit që mirëmbanin infrastrukturën kritike. Për momentin, Uashingtoni nuk ka ku përplasat tjetër, shkruante Tim Fernholz në The Quartz. Ka shpenzuar miliarda në përpjekje për të ndërtuar Boeing dhe Blue

Origin si alternativa private ndaj SpaceX, por ato nuk kanë dhënë produkt. Kompanitë e Musk ofrojnë vlerë për NASA dhe Pentagonin, dhe ai nga ana e tij, mbështetet tek financimet shtetërore. Ishte një goditje fati e pabesueshme për Elon Musk, që nevojat e Ukrainës u shfaqën pikërisht atëherë kur Starlink ishte në kërkim të dëshpëruar për tregje. Por kjo ndërvarësi nuk është e shëndetshme. Duhet të ndreqet, shkruante The Washington Post. Gjasat janë që Ukraina të mos jetë aleati i fundit i SHBA që ka nevojë

për internetin e shpejtë satelitor që ofron Starlink. Nëse Pekini do të shkëputte kabllo të nënujore të Taivanit, a do të mund të vareshin nga Musk, kur e dinë që “Tesla është e varur prej aftësisë së saj për të prodhuar makina në Kinë?” Fatmirësisht, Pentagoni ka lançuar një skemë 1.5 miliardë dollarëshe për të lëshuar 72 satelitë të vegjël në orbitën e ulët. Nuk është një numër i madh, Musk ka 4500. Por duhet të mjaftojë për të siguruar që “Starlink nuk është i vetmi opsion që ka bota”. Nuk duhet kurrë më që një njeri i vetëm të ketë kaq shumë kontroll. / bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



FFK-ja: Biletat e ndeshjes Kosovë - Zvicër janë të personalizuar

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar edhe një herë opinionin se biletat e ndeshjes Kosovë - Zvicër janë të personalizuar dhe nuk mund

të transferohen te një person tjetër. Në secilën hyrje të stadiumit funksionon sistemi digjital dhe do të bëhet kontrolli i poseduesve të biletave të personalizuar.

“Çdo abuzim me biletat do të paraqitet tek organet e rendit, me të cilat jemi duke bashkëpunuar ngushtë për parandalimin e keqpërdorimit të biletave për ndeshje. Andaj,

FFK fton qytetarët të mos bien pre e mashtruesve në tregun e zi dhe çdo abuzim me bileta ta paraqesin tek organet e rendit”, thuhet në njoftimin e FFK-së.



Kosova sonte përballlet me Zvicrën e shqiptarëve

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Kosovë-Zvicër është me shumë se një ndeshje futbollit, ani pse të dy ekipet kërkojnë pikët që janë të vlefshme për kualifikueset e Evropianit. Ndeshja që zhvillohet sonte (e shtunë) në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë për shumë kënd është edhe si një ndeshje “vëllazërore” pasi shumë lojtarë në Përfaqësuesen e Kosovës kanë lindur dhe janë rritur në Zvicër, derisa në ekipin zviceran janë katër shqiptarë në mesin e tyre edhe kapiteni Granit Xhaka. Përzgjedhësi Kosovës, Primozh Gliha dhe kapiteni Amir Rrahmani në konferencën për medie një ditë para ndeshjes janë shprehur të vetëdijshëm për kualitetin e lartë që ka ekipi zviceran, por kanë premtuar se ekipi dardan do të japë maksimumin. “Nëse dëshiron të kesh sukses, gjithmonë duhet të jesh në gjendje të punosh nën

presion dhe ta përballosh atë. Nëse doni alibi, atëherë mund të thuash se kishte presion. Në futboll duhet të kemi mendime pozitive dhe të marrim maksimumin në secilën ndeshje”, ka thënë Gliha, i cili me pas ka shtuar se gjatë këtyre pesë ditëve të grumbullimit kanë punuar mirë dhe janë munduar të gjejnë zgjidhjet e duhura për ta përballuar kundërshtarin. Sa i përket mundësisë që në formacion të ketë ndonjë befasi dhe inkuadrim të lojtarëve të rinj si Albion Rrahmani e Meriton Korenica, Gliha është shprehur: “Ata janë të ri, por janë të mirë dhe kjo është e rëndësishme. Përgjegjësia është shumë e madhe për ta në një ndeshje ndaj një kundërshtari të fortë si Zvicra. Të shohim cilat do të jenë vendimet, kemi disa probleme me lëndime. Nuk mund të flasë më shumë rreth formacionit, por mund të them se do të jetë e vështirë për të gjithë ata që do të luajnë”. Ndërkaq, kapiteni Amir Rrahmani që aktivizohet në Itali me Napolin,



ka thënë se Zvicra është një kundërshtar shumë i fortë. “Luajmë kundër më të fortit në grup dhe këtë ndeshje e mirëprisnim, ndonëse jo në këtë moment, pasi kemi shumë nevojë për pikë. Megjithatë jemi të përgatitur për të bërë më të mirën në fushë”, ka thënë Rrahmani. “Zvicra është një kombëtare shumë e fortë dhe shkon gjithmonë në Evropian apo Botëror. Janë shumë të fortë dhe bëhen edhe më të fortë me futbollistët shqiptarë që kanë në

grup”, ka deklaruar Rrahmani. Për ndeshjen ndaj Kosovës ka folur edhe shqiptari Granit Xhaka, i vlerësoi ndeshjen ndaj Kosovës si shumë të veçantë dhe emocionuese. “Një lojë e veçantë, për mua dhe familjen. Jam shumë i kënaqur që jam këtu. Nesër ndeshja do të jetë më shumë emocione. E njohim mirë Kosovën dhe lojtarët. Jemi përgatitur shumë mirë si gjithmonë. Nesër duhet me e tregu vetën në fushë. Ju e dini se unë ndihna si në shtëpi këtu, edhe

familja ime. Ndihem krenar që jam sot këtu. Shpresoj që nesër, edhe pse me fanellë tjetër, ju bëj edhe juve të lumtur. Babai im dhe xhaxhai im, i cili jeton këtu, do jenë nesër në stadium. Do të jenë edhe anëtarë të tjerë të familjes”, ka thënë Xhaka. Në pyetjen nëse do të pranonte që ndeshja të mbyllej baras, Xhaka duke qeshur ka deklaruar: “S’ka përgjigje”. Ndeshja mes Kosovës dhe Zvicrës do të zhvillohet nga ora 20:45, në stadiumin “Fadil Vokrri”.

Bardhi para ndeshjes me Italinë: Dëshirojmë rezultat pozitiv

SHKUP, 8 SHTATOR - Maqedonia e Veriut të shtunë në Shkup e pret Italinë për ndeshjen e vlefshme të eliminatoreve për Kampionatin Evropian 2024. Italianët duan hakmarrje për humbjen dhe eliminimin në “play-off” nga Maqedonia e Veriut që kishin marrë para një viti në Palermo. Kapiteni Enis Bardhi ka thënë se është nder për të ta bartë shiritin e kapitenit në një kombëtare ku ka shumë lojtarë udhëheqës. “Ky është një moment shumë emocionues për mua. Të jesh kapiteni i Maqedonisë nuk është punë e




vogël. Këtu ka shumë liderë dhe kapitenë, të cilët, edhe pse nuk mbajnë shiritin e kapitenit, janë të gjithë bartës të përfaqësueses”, ka thënë Bardhi. Futbollisti shqiptar ka bërë me dije se ndaj Italisë kanë synim të marrin një rezultat pozitiv. “Po hapim një faqe të re. Ne dëshirojmë një rezultat pozitiv.

Sigurisht që nuk do të jetë e lehtë, por besojmë në veten tonë. Kur një skuadër pëson ndryshime nuk është e lehtë. Kemi lojtarë të rinj që vijnë në përfaqësuese, kështu që nuk është e lehtë ta kalosh atë ndryshim. Besoj se kemi përvojën për ta menaxhuar këtë situatë dhe për të marrë një rezultat të mirë. Vetëm të bashkuan mund t'i arrijmë rezultatet e dëshiruara”, ka shtuar Bardhi. Ndeshja ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Italisë do të luhet në arenën “Todor Proeski”, me fillim nga ora 20:45.

Superkupa e meshkujve në Suharekë, e femrave në Prizren

SUHAREKË, 8 SHTATOR - Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), pas shqyrtimit të ofertave të dorëzuara për organizimin e Superkupës së Kosovës për edicionin 2023, ka marrë vendimet që të miratohet oferta e KB Golden Eagle Ylli për organizimin e Superkupës së Kosovës në konkurrencën e meshkujve në më 13-17 shtator 2023. Po ashtu, Bordi i FBK-së udhëzon KB Golden Eagle Yllin t'i fillojë përgatitjet e nevojshme në përputhje të udhëzuesit për



organizimin e Superkupës së Kosovës dhe akteve të tjera normative. U miratua edhe oferta e KBF Bashkimi për organizimin e Superkupës së Kosovës në konkurrencën e Femrave në bashkëpunim me FBK-në.

Kosova fiton miqësoren e dytë ndaj Maqedonisë së Veriut

Podujevë, 8 shtator - Përfaqësuesja e Kosovës U17 ka shënuar fitore në miqësoren e dytë kundër Maqedonisë së Veriut U17 me rezultat 2-1. Edhe kjo ndeshje u zhvillua në stadiumin “Zahir Pajaziti” në Podujevë. Të parët në

epërsi kaluan futbollistët mysafirë me golin e shënuar nga Hisar Ali në minutën e 21-të (1-0). Në pjesën e dytë “dardanët” e rinj u angazhuan më shumë në kërkim të golit dhe në minutën e 75-të arritën t'i barazojnë shifrat

përmes Leart Salihut. Ky gol iu dha energji shtesë, të cilët në minutën e 90, pas këmbënguljes së madhe, arritën ta gjejnë golin e fitores, kur Ermal Krasniqi shënoi për rezultatit përfundimtar 2-1.



Daku shpërthen në lot: Luftojmë për ta bërë krenar popullin tonë

Tiranë, 8 shtator - Mirlind Daku debutoi me Kombëtaren e Shqipërisë në barazimin 1-1 ndaj Çekisë në Pragë. Sulmuesi nga Gjilani, i cili luan në Rusi me Rubin Kazan, u përlot në

prononcimin për emisionin "KUQEZI" në "SuperSport". "Jam pa fjalë. Isha i emocionuar që arrita të debutoja me Kombëtaren shqiptare. Ka qenë një çast shumë i mirë për mua dhe

familjen time. Lotët? Për këtë arsye luftojmë që të bëjmë krenar popullin tonë. Kjo është më shumë se një Kupë Bote kur sheh gjithë ata njerëz duke na përkrahur. Rasti? Mendova

ta shtyja topin te Bajrami. Mendova se ishte ofside dhe vendosa të pasoj te Muja. Nuk deshi Zoti. Shpresoj që ndeshjet e ardhshme do të jemi më syhapur", ka deklaruar Daku.



Bajrami: Golin më të bukur të karrierës e festova me babin

TIRANË, 8 SHTATOR - Nedim Bajrami shënoi super gol në ndeshjen ndaj Republikës Çeke, duke i dhuruar një pikë Kombëtares së Shqipërisë (1-1). Fantazisti i Sassuolos ka thënë se goli i shënuar ndaj çekëve ishte më i miri në karrierën e tij. "Goli më i bukur i karrierës? Po, besoj se është goli më i bukur i karrierës. Jam shumë i lumtur që e ndihmova skuadrën. Të vazhdojmë kështu. Ndeshja e radhës është afër. Kemi shumë kualitet në skuadër. Duhet t'i shfrytëzohim rastet. Çekia është skuadër fizike. Nuk kishim shumë raste, por i shfrytëzuam ato që kishim. Futbollit kështu është, një rast një gol. T'i përmirësojmë ato gjëra që nuk kemi bërë shumë mirë. Roli në fushë? Jam i lumtur. Ndhim shumë mirë pas sulmuesit. Çdo lojtar duhet të japë maksimumin", ka thënë Bajrami.



I pyetur se a e ka ndier besimin e trajnerit Sylvinho, Bajrami është përgjigjur: "Ai më ka ndihmuar shumë mentalisht. Kam shumë vetëbesim me Sylvinhon. Duhet

të vazhdoj kështu, që ta ndihmoj sa më shumë skuadrën. E festova golin me babin. I thashë të dua shumë. Shpresoj të shënoj edhe ndaj Polonisë".

Trajneri i Çekisë: Turp që nuk fituam ndaj Shqipërisë

PRAGË, 8 SHTATOR - Pas barazimit 1-1 në shtëpi ndaj Shqipërisë, trajneri i Republikës Çeke, Jaroslav Silhavy, është shprehur i zhgënjyer me ekipin e tij. Ai ka thënë se është turp që ekipi nuk ia doli të fitonte. "Padyshim që humbëm dy pikë. Jemi të zhgënjyer. Djemtë hynë kokulur në dhomat e zhveshjes. Shënuam dy gola, vetëm një ia vlen. Pas gabimit tonë, i ofruam kundërshtarit një gol barazimi, por më pas nuk mundëm ta kthenim ndeshjen në favorin tonë. Është turp. Duhet të kishim fituar", ka thënë Silhavy. "Edhe ne u befasuam nga kjo. Ishim gati për ndeshjen, e dinim se sa e rëndësishme ishte, por pastaj u dukëm të nervozuar dhe pati pak zënka. Fatkeqësisht, pjesa e parë nuk na funksionoi fare. Jam i lumtur që u përmirësuam dhe u paraqitëm më mirë në të dytën. Megjithatë, Shqipëria është



vetëm një pikë prapa jush, Polonia po ecën. Një komplikacion mjaft i madh për zhvillimin e mëtejshëm në grup. Fatkeqësisht, kemi vetëm një pikë dallim. Kualifikimi ka ende punë. Shqipëria luan me Poloninë, pastaj shkojmë në Shqipëri... Është turp që nuk fituam këtu", ka

deklaruar Silhavy, i cili më pas ka treguar edhe arsyen pse e ka zëvendësuar golashënuesin Cerny, i cili dukej më aktiv në fushë: "Ne kishim sulmues të tjerë në bankinë, të cilët prisnin një shans. Ne donim të kishim në fushë lojtarë më të fuqishëm dhe golashënues".

SHKURT

Neymari: Kampionati në Arabi, më i lartë se ai në Francë

"Topi është kudo i rrumbullakët dhe futbollit luhet kudo në botë", në këtë mënyrë sulmuesi brazilian Neymar, me shumë thjeshtësi, shpjegon arsyen se përse vendosi të largohet nga PSG-ja për të luajtur në Arabinë Saudite, me skuadrën e Al-Hilalit. "Duke parë emrat e mëdhenj që ndodhen në këtë kampionat, me shumë gjasë kampionati i Arabisë Saudite është më i mirë se ai francez. Stërvitjet janë shumë intensive dhe unë këtu dua të fitoj tituj", ka thënë Neymari. "Dua që me Al-Hilalin të fitoj sa më shumë, ndaj vendosa të transferohem këtu. Niveli është i lartë dhe diferenca ndihet me afrimet e reja", ka shtuar sulmuesi brazilian nga grumbullimi i kombëtares së vendit të tij.

Rauli, afër të emërohet trajner i Villarealit

Legjenda e Real Madridit, Raul Gonzalez, do të diskutojë sot me Villarealin për një vendim përfundimtar rreth çështjes së tij për t'u bërë trajner i klubit. Siç shkruan gazetari sportiv Fabrizio Romano, Real Madridi është i hapur për ta lënë të lirë Raulin në rast se ky i fundit dëshiron ta pranojë ofertën e Villarealit. Diskutimet do të pasojnë duke pritur që Villarreali të vendosë për zëvendësimin e Quique Setien.

Salahu mbetet në Liverpool

Të enjten në mbrëmje ka përfunduar afati kalimtar në Arabinë Saudite. Klubet arabe shpenzuan rekord para për transferimin e top-yjeve të futbollit evropian atje. Megjithatë, ata nuk arritën ta sillnin edhe Mohamed Salahun. Al-Ittihadi tentoi deri në orët e fundit për transferimin e egjiptianit, por Liverpooli refuzoi shumën rekord parash deri në 230 milionë euro për të.

Ramosi mund të kthehet në Kombëtaren e Spanjës

Trajneri spanjoll Luis de La Fuente nuk ia mbyll derën e kombëtares Sergio Ramosit, tashmë pjesë e Sevilas në La Liga, ekip ku u kthye pas 18 vjetësh. "Detyra ime është t'i thërras lojtarët më të mirë në këtë kohë. Këtu janë më të mirët për këto dy angazhime (Gjeorgjia dhe Qiproja). Deri në tetor nuk e di se çfarë do të ndodhë", ka thënë La Fuente në lidhje me dëshirën e qendërmbrojtësit 37-vjeçar për ta riveshur fanellën e "La Rojas". Sfidat e fundit të Sergio Ramosit, lojtar që ka veshur më së shumti fanellën e përfaqësueses (180 ndeshje dhe 23 gola), ka qenë kundër Kosovës në mars të vitit 2021.

Giroud pas lëndimit: Nuk jam i shqetësuar

Sulmuesi Olivier Giroud pas 25 minutash lojë u detyrua të largohet për shkak se mori një goditje në kavigj. Sulmuesi francez ka bërë me dije se një

goditje të njëjtë e kishte marrë edhe në ndeshjen e Ligës së Kampionëve ndaj Napolit në edicionin e kaluar. "Bëra një lëvizje të çuditshme në të

njëjtin kyç të këmbës ku kisha marrë një goditje në Ligën e Kampionëve kundër Napolit nga Kim. Tani për tani kam një dobësi, por të

menaxhueshme. Nuk kam pasur dhimbje prej javësh. Doja të vazhdoja, por kyçi i këmbës më tha ndal. Tani jam më mirë. Nuk jam shumë i

shqetësuar. Do të bëj disa analiza, por nuk jam shumë keq. Derbi? Po, po, mendoj se mund të luaj", u shpreh Giroud.



KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 07.09.2023 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeqare, KRM"Uniteti" Sh.A vendosi që më datë 09.09.2023 të shpall:

KONKURS Publik

Për plotësimin e vendit të punës:

Kontabilist/e i/e arkave, llogaritës/e i/e të Ardhurave Personale, Arkëtar/e – Mitrovicë me kohë të caktuar (me kohëzgjatje një/1 vjeqare) , me mundësi vazhdimi
Numri i referencës: 09-07-41

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Mbajtja dhe përgjegjësia për arkën, pranimit të hollave të gatshme, dhe dorëzimi i tyre në bankat kompetente;
- Pagesa dhe inkasimi nëpërmjet arkës, ngarkesat dhe shkarkesat e inkasantëve me fatura çdo ditë dhe kur ka nevojë;
- Mbajtja dhe përfundimi i përditshëm i ditarit të arkës si dhe regjistrimi i tij në kontabilitet (kontimi i arkës-Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj);
- Përgjegjësia materiale, penale dhe rregullësia në punë për mjetet monetare dhe të tjera me të cilat është e ngarkuar;
- Kujdesi për sigurinë me rastin e marrjes dhe bartjes të së hollave dhe letrave me vlerë;
- Llogaritja e pagave dhe akontacioneve, transferimi i rrogave në llogari personale të punëtorëve (kontimi i pagave në Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj);
- Raportimi tre mujor i kontributeve pensionale si dhe rroga vjetore e punëtorëve në Administratën Tatimore të Kosovës dega në Mitrovicë;
- Si dhe punë tjera sipas urdhërësës së eprorit drejtëpërdrejtë .

Kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë diplomë Universitare;
- Të prezantoj letrënjoftimin;
- Shkathësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Exel);
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës)

Kushtet e veçanta:

Punëtori gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë.
Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 09.09.2023 deri më datën 23.09.2023. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Flamur Miftari nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme teknike "Nexhmendin Nixha".

- Flaka Hoxha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme "Hajdar Dushi".

- Lahë Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme "Hysni Zajmi" (Nexhemdin Nixha).

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Arjeta Rizanaj shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHME "Ymer Prizreni" Prizren.

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Egzona Ponik shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHFMU "Fadil Hisari" Prizren.

- AJET HAJRA, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se larte "ARKITEKT SINANI" ish-shkolla "Boris Kidriç".

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- ARDITA MORINA, shpall të pavlefshme ID e Fakultetit AAB, drejtimi JURIDIK me nr: FJUP/0027-T19/22.

- ENVER PEÇI, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës së lartë Ekonomike Komeriale në Pejë, numër të dosjes: 183/1975 dhe numër të diplomës: 01-210/66.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

